



- Të reja ▾Kush jemi ▾HistorikuShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjetVideoProgrami i transparencës ▾Kontakt
- Denonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾DonacionePolicimi në Komunitet
- Përmbledhja MujorePër sinjaliziminTë Guximshëm pa Armë

Breaking News:

Tiranë/Shërbimet “Shqiponja” godasin një tjetër rast të shitjes së lëndëve narkotike të llojeve të ndryshme



Lajmet

08/09/2026

Tiranë/Shërbimet “Shqiponja” Godasin Një Tjetër Rast Të Shitjes Së Lëndëve Narkotike Të Llojeve Të Ndryshme

Tiranë/Shërbimet “Shqiponja” godasin një tjetër rast të shitjes së lëndëve narkotike të llojeve të ndryshme.

Sekuestrohen doza të lëndëve narkotike Kokainë dhe Cannabis Sativa, përzierje Crack dhe municion luftarak.

Kapet në një automjet të parkuar në rrugën “Jordan Misja”, duke ndarë lëndët narkotike, me qëllim shitjen, 27-vjeçari, i cili sapo konstatoi shërbimet, tentoi të largohej me vrap.

Në vijim të aksioneve policore, për identifikimin dhe ndalimin e shtetasve të përfshirë në veprimtari kriminale në fushën e narkotikëve, si dhe si rezultat i intensifikimit të punës operative me këtë objekt, shërbimet e Forcës së Posaçme “Shqiponja” goditën një tjetër rast të sigurimit të llojeve të ndryshme të lëndëve narkotike dhe shitjes së tyre në doza.

Për rastin, specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve vunë në pranga shtetasin J. C., 27 vjeç, banues në Paskuqan.

Ai është konstatuar në një automjet të parkuar në rrugën “Jordan Misja”, duke ndarë lëndë narkotike, me qëllim shitjen në zona të ndryshme të kryeqytetit, dhe sapo ka parë shërbimet ka tentuar të largohet me vrap. Pas kapjes, 27-vjeçarit i janë kryer kontrole fizike dhe në automjet, si rezultat i të cilëve i janë gjetur doza të lëndëve narkotike Kokainë dhe Cannabis Sativa, përzierje Crack dhe municion luftarak.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.



◀ Krujë/Arrestohet në flagrancë autori i një rasti zjarrvënieje në fshatin Zallë

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month



Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent